



# **SJELLJA JO E MIRË AKADEMIKE**

**Rregullat dhe ndëshkimet**

Autor: Alban Asllani



2013

# Sjellja jo e mirë akademike

Në Kolegjin Universum, sjellje jo të mira akademike dhe pandershmëri akademike konsiderohen:

- Plagjiatura
- Dorezimi i punimit të njejt me shumë se një here
- Marrëveshjet/bashkpunimet e fshehta mes studenteve
- Kopjimi gjatë provimeve dhe kollokfiumeve
- Kopjime tjera dhe mos referencime/citime adekuate

Më poshtë do të gjeni rregullat dhe ndëshkimet për sjelljet e listuara më lartë.

## Plagjiatura

1. Plagjiatura është përdorimi dhe prezantimi i punës, fjalëve, ideve të dikujt tjetër, si të ishin të studentit. Andaj, shumica e formave të kopjimit gjatë provimeve është plagjiaturë, por termi perdoret zakonisht në referencë të letrave, hulumtimeve, detyrave me shkrim, eseve dhe raporteve.
2. Si e tillë, nëqoftëse do të përdoreni punën e dikujt tjetër, ju duhet të referenconi atë në mënyrë të përshtatshme sipas kriterëve të citimit. Çdo citat nga veprat e botuara apo të pabotuara të autoreve të tjerë, duhet të identifikohet qartë duke u vendosur brenda thonjëzave, dhe studentët duhet të identifikojnë burimet e tyre saktë dhe sa më të plota që të jetë e mundur.
3. Plagjiatura përfshin:
  - Kopjimi dhe bartja e informacionit nga burimi elektronik apo i shtypur në punimin tuaj pa e cituar atë.
  - Marrëveshjet e fshehta, ku dy apo më shumë studentë punojnë në të njejtën temë dhe e shfaqin atë si punë të tyre individuale.
  - Blerja e punimeve dhe paraqitja e tyre si punime tuajat; qofshin këto punime ekzistuese apo të shkruara më herët, duke përfshirë edhe faqet në internet që e mundësojnë këtë shërbim.
  - Ndryshimi i fjalive, por kopjimi i strukturës së fjalise, pa e referencuar atë.
  - Kopjimi i shumë ideve dhe fjalive nga një burim i vetëm, e cila përbën një pjesë të madhe të punimit tënd.
  - Dorëzimi i punimit më shumë se një herë.
  - Mos referencimi i punës – Përdor sistemin Harvard ose Vancouver të referencimit. Ju lutem shiqoni udhëzuesin për këtë. Ju mund të përdoreni edhe sisteme tjera të referencimit por duhet konsultuar me profesorin e lëndës paraprakisht.
  - Përkthimi i fjalive nga një gjuhë tjetër, pa e referencuar atë në mënyrë adekuate.

#### 4. Rregullat:

- i. Gjatë shkrimit të punimit tuaj, është në rregull përdorimi i punës së tjetrit, por nëse përdoren si duhet rregullat e citimit, respektivisht Sistemi Harvard apo Vancouver i citimit (ose sistemet tjera). Ju lutem shiqoni udhëzuesin për këtë. Në fakt, është me rëndësi përdorimi i shumë burimeve të ndryshme për një temë të caktuar në shkrimin e punimit tuaj. Profesori mund të ju vlerësojë për referencim të burimeve të ndryshme. Kjo tregon se keni hulumtuar dhe lexuar disa burime/artikuj.
- ii. Çmoje burimin duke e cituar atë në shkrimin tënd dhe duke i dhënë referencë të plotë në fusnotë apo në listën e referencave në fund të punimit apo duke përdorur referenca të stilit të Harvardit apo Vancouver (ose sisteme tjera të referencimit). Të gjitha referencat në fund të shkrimit tuaj të listuara quhen "Bibliografi", dhe kjo duhet të jetë pjesë e veqante e punimit tuaj.
- iii. Syllabusi duhet të tregojë format e citimit që profesori pret të shohë në shkrimet tuaja. Nëse gjatë shkrimit tuaj ju merrni fjalë për fjalë tekstin nga një libër tjetër, atëherë tekstin e marrë duhet ta fusni në thonjëza. Citime të tilla mund të jenë të përshtatshme për shkrimin tuaj por duhet të rrespektohen rregullat. Gjithsesi, nëse përdoreni shumë citate në punimin tuaj, kjo nuk është plagjiaturë, por kjo nuk është shkrim/ punë e juaj , andaj ju mund të notoheni me notë më të dobët për këtë.
- iv. Në rastin e ideve të njerëzve të tjerë, mund të jetë e vështirë të përcaktoni se çfarë duhet të citoni e çfarë jo. Kjo për shkak se ka "njohuri të përbashkëta" për temën dhe nivelin e studimit. Nëse nuk jeni të sigurtë se cilat ide duhet cituar, atëherë ju duhet të konsultoni ligjëruesin apo profesorin tuaj, apo udhëzuesin nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë dhe nga Zyra e Karrierës. Nëse jeni të pasigurtë, është më mirë të siguroheni duke e cituar atë.
- v. Informatat e marra nga interneti duhet të citohen njejtë si informatat e marra nga librat apo gazetat, dhe ju duhet të jepni datën kur jeni casur informacionit.
- vi. Referencimi i gjithë punës duhet bërë në përputhje me rregulloren e Kolegjit Universum. Një udhëzues i veqante është përgatitur për ju për mënyrat e ndryshme të citimit.
- vii. Plagjiatura është plagjiaturë pavarësisht nëse e keni bërë me qëllim apo pa qëllim. Studentët duhet të sigurohen se i kuptojnë parimet e të çmuarit të punës së tjetrit dhe duhet ta citojnë në mënyrë të duhur atë, sipas rregullave akademike.
- viii. Kjo rregullore i dallon plagjiaturat e vogla dhe ato të mëdha apo shkeljet e vogla dhe ato të mëdha.
- ix. Plagjiaturë në masë të vogël karakterizohet nga kuotimet të pa-atribuara; parafrazime të papërshtatshme ose zëvendësim i fjalëve në tekst; mos citimi, citimi i pasaktë ose i paplotë, dhe/ose kopjimi i disa paragrafëve pa citim të burimit. Parafrazimi i papërshtatshëm është plagjiaturë – pra marrja e tekstit të dikujt tjetër dhe riorganizimi apo zëvendësimi i fjalëve për të fshehur atë.

- x. Plagjiaturë në masë të madhe karakterizohet kopjimi i shumë paragrafeve nga burimet publike duke mos i cituar ato; apo dorëzimi i punimit të njejt me shumë se një here dhe për disa lëndë (pa lejen e profesorit), punimi fare i pa referencuar; apo tentimi ose blerja e punimeve nga studentët tjerë, apo web faqet të cilat mirren me këto sherbime.
- xi. Ka ngjajshmëri në mes të bashkëpunimeve të vogla dhe të mëdha. Keni parasysh se dorëzimi i punimit së dikujt tjetër si i juaji është shkelje akademike.
- xii. Nëse Profesori dyshon në punën tuaj për plagjiaturë, atehërë ai/ajo do të përpiqet që të gjejë burimin. Edhe nëqoftëse profesori nuk mund të gjejë burimin, por prap dyshon për plagjiaturë, ai mund të kërkojnë nga Drejtori i departamentit të vërtetojë këtë. Nëse punimi ka plagjiaturë, Drejtori i departamentit do të njoftojë profesorin dhe do të ftojë studentin në bashkëbisedim për të diskutuar këtë problem. Nëse studenti mungon, ai/ajo mund të përfaqësohet nga një anëtar tjetër i Kolegjit, por kesaj duhet me cdo kusht të ju shmanget studentit.
- xiii. Nuk kërkohet një provë absolute për të dëshmuar plagjiaturën. Mjafton të dyshohet që ka pasur plagjiaturë nga profesori dhe drejtori i departamentit dhe për të vendosur që studentit ka bere shkelje akademike nuk është nevoja të dalim “përtej dyshimit të arsyeshëm ose logjik”.
- xiv. Shkeljet e para të vogla trajtohen si gabime për shkak të kuptimit të dobët të shkrimit akademik. Kjo kategorizohet si "punë e papranueshme"; punimi nuk pranohet dhe duhet të korigjohet. Kjo përbën veprën e parë dhe regjistrohet në dosjen e studentit.
- xv. Shkelja e dytë është kur përsëritet rasti – pra nëse studentit pavarësisht vërejtjes së parë vazhdon për herë të dytë me të njejtën shkelje. Të gjitha shkeljet regjistrohen. Profesori/Ligjëruesi do të mbaje shënime për detajet e rastit. Shënimet për shkelje mbahen të hapura derisa studentit të përfundojë programin e studimit. Nëse vërtetohet se për rastet e hapura nuk ka shkelje, rasti nuk regjistrohet. Pasi që është marrë vendimi, studentit mund të apelojë kundër saj, por vetëm në aspektin e parregullsisë procedurale.
- xvi. Të gjitha shkeljet referohen nga ligjëruesi tek Udhëheqësi/Drejtori i Departamentit apo Drejtori Akademik. Udhëheqësi/Drejtori i Departamentit fton studentin për bashkëbisedë me Drejtorin Akademik dhe Profesorin/Ligjëruesin. Profesori/Ligjëruesi paraqet rastin dhe studentit intervistohet më pas, me një përfaqësues në qoftë se studentit dëshiron ose e sheh të nevojshme, por i cili duhet të jetë një anëtar i kolegjit. Paneli Intervistues mund të merr parasysh të gjitha rrethanat në të cilat ishte studentit. Paneli mund të rekomandojë ndonjë ndëshkim, dhe studentit mund të përjashtohet në këtë fazë.
- xvii. Në raste të bashkëpunimit të studentëve, ku profesori nuk mund të vërtetojë fajësinë e secilit student vec e vec, profesori mund të refuzojë punimin e të gjithë studentëve në të cilët dyshon për plagjiaturë apo bashkëpunim. Punimet konsiderohen si “punime të papranueshme” dhe mund të kërkohet që brenda një afati të caktuar kohore, punimi të ridorëzohet i korigjuar. Në rast se profesori identifikon fajtorin, studentit në fjalë trajtohet sipas tabelës një (1) më poshtë.

- xviii. Studentët e ftuar në intervistë nga Udhëheqësi/Drejtori i departamentit dhe Drejtori Akademik, duhet të konsultohen me profesorin e tyre paraprakisht.
- xix. Tabela e mëposhtme tregon nivelin e ndëshkimeve për raste të ndryshme në Kolegj. Kjo aplikohet për të gjitha lëndët dhe gjithë studentët e Kolegjit Universum.

Shkeljet plagjiature	Të vogla	Të mëdha
Shkelja e parë	Notën origjinale, (nëse studenti në atë punim të lendes është notuar njëhere por me vone është dyshuar për plagjiature), e merr në momentin që dorëzon verzionin e pranueshëm. Nota finale do ti jepet sipas meritës, por nuk do të tejkalojë notën origjinale që iu është dhene në punim. Nga studenti kërkohet që të merr udhëzime të përshtatshme dhe praktikë në shkrim akademik. Në dosjen e studentit regjistrohet sjellja jo e mire akademike.	Studenti merr paralajmërim me shkrim për sjellje jo të mirë akademike dhe vlerësim me notën zero për punimin përkatës, dhe me pasoja në rivlerësim. Në dosjen e studentit regjistrohet sjellja jo e mire akademike.
Shkelja e dytë	Studenti merr paralajmërim me shkrim për sjellje jo të mirë akademike dhe vlerësim me notën zero për punimin përkatës, dhe me pasoja në rivlerësim. Në dosjen e studentit regjistrohet sjellja jo e mire akademike.	Studenti merr paralajmërim me shkrim për shkelje akademike plus merr notimin me notën zero për të gjithë lëndën, dhe studentit i kërkohet të perserite tere lenden/modulin në vitin apo semestrin tjetër akademik. Në dosjen e studentit regjistrohet sjellja jo e mire akademike.
E treta dhe të tjerat	Studenti drejtohet tek shefi/Udhëheqësi i Departamentit:  Vërejtje:  1. Nota për lende/modul limitohen në minimum, studenti mund të merr vetem notë kaluese nëse përfshihet në ndonjë rivlerësim. 2. Vendosja e notës zero nënkupton që të gjitha metodat/komponentet e vlerësimit të vleresohen me zero, pavarësisht nëse është vlerësimi i parë apo ri-vlerësim. 3. Studenti duhet ta rimarr lëndën vitin ose semestrin që vjen.	Studenti i drejtohet Udhëheqësit të Departamentit dhe Drejtorit Akademik.  Vërejtje: 1. Studenti përjashtohet nga Kolegji.

Tabela 1: Rregullorja për plagjiaturë dhe ndeshkimet në Kolegjin Universum

## **Sjelljet tjera jo të mira akademike**

### **Kopjimi në provime**

5. Kopjimi i përgjigjeve nga studentët tjerë, apo referimi pa leje në libra, kompjuterë, laptop, dhe/apo referimi tek shënimet në telefon mobil. Gjithashtu, përdorimi i telefonave për të diskutuar apo marrë përgjigjet nga një student tjetër, pavarësisht nëse është present në klas apo jo, është i ndaluar.
6. Mashtrim apo kopjim është gjithashtu edhe ndryshimi i pyetjeve në provim dhe pastaj të kërkohet vlerësim. Është përgjegjësi e studentit të dorëzojë provimin ashtu sic e ka pranuar; cdo ndryshim është sjellje jo e mirë akademike.
7. Për provimet “me liber të hapur”, ose për provimet shtëpiake (ku studenti e merr provimin në shtëpi dhe përgjigjet në pyetjet e provimit), ose për provimet me pyetje të cilave jepen paraprakisht, profesorët duhet ti bëjnë të qarta rregullat, dhe studentët duhet ti përmbahen atyre. Nëse një student është në hamendje përsa i përket kuptimit të udhëzimeve, ai ose ajo duhet të kërkojë sqarim nga profesori. Pritja e zakonshme është që çdo student do të përgatisë përgjigjet e tij ose të saj vetë; bashkëpunim me të tjerët është e pranueshme vetëm nëse është kërkuar nga profesori. Në të gjitha rastet, përgjigjet që studenti i dorëzon duhet të përfaqësojnë mendimet dhe të kuptuarit e tij. Nëse studenti mendon se përgjigjet e tij/saj janë të ndikuara nga librat apo mendimet e të tjerëve, duhet të cek këtë në punim dhe të citon/referencon burimet.
8. Mund ti drejtoheni tabelës (tabela 1) më lartë për ndëshkimet e parapara.

### **Dorëzimi i shumëfishtë**

9. Studentët nuk duhet të dorëzojnë të njëjtin punim në më shumë se një lëndë apo me shumë se një here. Nëse temat për dy punimet përputhen, studenti duhet të ketë leje të shkruar nga dy profesorët e lëndëve para se të kombinojë punën në dy punime apo të rishiqojë/riorganizoj punimin e mëparshëm dhe ta dorëzojë atë për lëndën e re.
10. Mund ti drejtoheni tabelës (tabela 1) më lartë për ndëshkimet e parapara.

## REFERENCAT:

Burimet e mëposhtme janë përdorur për të hartuar këtë regullore.

- <http://www.ucl.ac.uk/current-students/guidelines/plagiarism>
- <http://www.lse.ac.uk/resources/calendar/academicRegulations/RegulationsOnAssessmentOffences-Plagiarism.htm>
- <http://yalecollege.yale.edu/content/cheating-plagiarism-and-documentation>
- <http://www.keele.org.uk/docs/guidetoregs.pdf>
- <http://plagiarism.org/>
- <http://plagiarism.org/citing-sources/overview/>
- <http://plagiarism.org/ask-the-experts/overview/>
- <http://plagiarism.org/resources/overview/>

### INFORMATA TË MËTUTJESHME DHE NDIHMË PËR STUDENTËT:

- Konsultohuni me profesorin tuaj
- Konsultohuni me Zyrën e Karrierës
- Konsultohuni me kolegun tuaj
- Konsultohuni me Zyrën për Sigurim të Cilësisë
- Lexojeni dokumentin 'Citimi i Referencave & Shmangja nga Plagjiatura'
- Ju lutem shiqoni në Web faqet e mëposhtme për informata shtesë:
  - <http://plagiarism.org/>
  - <http://plagiarism.org/citing-sources/overview/>
  - <http://plagiarism.org/ask-the-experts/overview/>
  - <http://plagiarism.org/resources/overview/>

### INFORMATA TË MËTUTJESHME DHE NDIHMË PËR PROFESORET/LIGJËRUESIT:

- Ju lutem konsultohuni me Zyrën për Sigurim të Cilësisë
- Ju lutem shiqoni Web faqet e mëposhtme për informata shtesë:
  - <http://plagiarism.org/>
  - <http://plagiarism.org/citing-sources/overview/>
  - <http://plagiarism.org/ask-the-experts/overview/>
  - <http://plagiarism.org/resources/overview/>